

Banka e Shqipërisë

**PUBLIKIMI I STATISTIKAVE
MONETARE DHE FINANCIARE SIPAS
STANDARDIT TË RI METODOLOGJIK**

DEPARTAMENTI I STATISTIKAVE FINANCIARE

TETOR 2016

PËRMBAJTJA

<i>PUBLIKIMI I STATISTIKAVE MONETARE DHE FINANCIARE SIPAS STANDARDIT TË RI METODOLOGJIK</i>	4
<i>KLASIFIKIMI I KUNDËRPARTISË</i>	6
<i>PUBLIKIMI I TË DHËNAVE</i>	9

PUBLIKIMI I STATISTIKAVE MONETARE DHE FINANCIARE SIPAS STANDARDIT TË RI METODOLOGJIK

Për përmbushjen e objektivave kryesorë ligjorë, Banka e Shqipërisë harton dhe publikon statistikave monetare dhe financiare bazuar në statistikave të bilanceve të gjendjes së institucioneve monetare financiare (MFI), të cilat janë ndër statistikave kryesore të përdorura nga Banka e Shqipërisë dhe sigurojnë informacion kyç për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare në Shqipëri.

Në cilësinë e agjencisë statistikore, Banka e Shqipërisë është e angazhuar të përmirësojë dhe rrisë cilësinë e statistikave të prodhuara, duke ndjekur dhe zbatuar standardet dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Nevoja për të dhëna të plota dhe të besueshme monetare dhe financiare në të gjitha vendet është theksuar nga episode të paqëndrueshmërisë financiare, në mënyrë të veçantë ato të viteve 2008-2009. Në këtë kontekst, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka marrë rolin udhëheqës në promovimin e statistikave monetare dhe financiare metodologjikisht të shëndosha dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht (Manuali dhe guida e kompilitimit të statistikave financiare dhe monetare, 2016).

Metodologjia dhe konceptet e përshkruara në standardin e ri të hartimit të statistikave monetare dhe financiare janë në përputhje me grupet e tjera makroekonomike të të dhënave, duke përfshirë Sistemin e Llogarive Kombëtare 2008 (në sistemin evropian të Llogarive ESA 2010), në edicionin e gjashtë të Manualit të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare (BPM6), si dhe të Manualit të Statistikave Financiare Qeveritare 2014 (GFSM 2014). Ky harmonizim nënvizon marrëdhënien e ngushtë që ekziston midis sistemeve të ndryshme makroekonomike statistikore.

Në përgjigje të këtyre standardeve të reja metodologjike, Departamenti i Statistikave Financiare ka përgatitur dhe publikon sot tabelave statistikore të përmirësuara për statistikave monetare dhe financiare, të cilat ndikojnë të gjitha tabelat e bilanceve sektoriale dhe paraqitjet monetare të korporatave depozituese, si dhe disa tabelave të reja e të përmirësuara për instrumentet kryesore financiare të bilanceve të bankave, të tilla si: huatë dhe depozitat, duke hedhur një hap përpara drejt harmonizimit të statistikave të prodhuara nga BSH-ja me kuadrin statistikor evropian dhe më gjerë.

Hartimi dhe publikimi i tyre vjen në zbatim të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 80, datë 06/07/2016 "Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar".

Standardi kryesor i përafuar në këtë publikim është ai i cili konsideron klasifikimin e sektorëve (ose sektorizimi) kundërpartit (konform ESA 2010).

Në treguesit e përmirësuar statistikorë të Bankës së Shqipërisë, sektorizimi, veçanërisht për instrumentet kryesore, të tilla si "hua" e "depozita" paraqitet sipas korrespondencës së mëposhtme:


Sektorët sipas metodologjisë ekzistuese	Sektorët sipas metodologjisë së re
	Sektorët rezidentë
Qeveria qendrore	Qeveria qendrore
Qeveria rajonale	-
Qeveria lokale	Qeveria lokale
Të tjera	Fondet e sigurimeve shoqërore
Banka qendrore	Banka qendrore
Bankat	Bankat
Institucionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare	Shoqëritë e kursim - kreditit
	Fondet e investimeve të tregut të parasë
	Fondet e investimit
	Ndërmjetës të tjerë financiarë (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit vullnetar)
	Ndihmësit financiarë
	Shoqëritë e sigurimit
	Fondet e pensionit vullnetar
Njësi tregtare dhe industriale publike	Korporata jofinanciare publike
Njësi tregtare dhe industriale private	Korporata jofinanciare private
Individët	
Punonjësit e bankës	Individët/ekonomitë familjare
Klientë të tjerë	
	Institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve

Për grupin "Institucionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare" detajimi në nënsektorët e sektorit të korporatave financiare është mjaft i dukshëm dhe paraqet me detajet e duhura cilat njësi nga nënsektorët janë mbajtës të pretendimeve apo detyrimeve në marrëdhëniet financiare që ata krijojnë.


Gjithashtu, "Institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve", për tabelat e depozitave dhe huave paraqiten si sektor i veçantë, ndërsa për të dhënat e korporatave depozituese paraqitet bashkë me "Individët/ekonomitë familjare", në nëngrupin "Sektorë të tjerë rezidentë."

Banka e Shqipërisë publikon për herë të parë të dhënat e muajit shtator 2016 me këtë standard metodologjik dhe rishikon serinë kohore, për treguesit e paraqitur në të dhënat e korporatave depozituese, bilancet sektoriale dhe paraqitjet monetare, si dhe huatë e depozitat që nga muaji dhjetor i vitit 2015. Për shkak të sektorizimit të detajuar, në treguesit e përmirësuar vërehet një zhvendosje e lehtë e vlerave të disa treguesve, kryesisht të huasë dhe depozitave, si në paraqitjet grafike të mëposhtme:

Grafik 1. Riklasifikimi i instrumentit "Hua" sipas nënsektorëve (milionë lekë)



Grafik 2. Riklasifikimi i instrumentit “Depozita të përfshira në paranë e gjerë” sipas nënsektorëve (milionë lekë)



Për instrumentin “Hua” vërehet një zhvendosje e vlerave të huasë nga “Sektori i korporatave të tjera jofinanciare” në nënsektorin “Sektorë të tjerë rezidentë” apo individë/ekonomitë familjare. Kjo zhvendosje vjen si rrjedhojë e saktësisimit të klasifikimit për personat fizikë, nga nënsektori i korporatave jofinanciare në nënsektorin e “Individëve”.

Për sa i përket instrumentit “Depozita të përfshira në paranë e gjerë”, për shkak të sektorizimit vërehet një zhvendosje e depozitave nga nënsektori i “Korporatave të tjera jofinanciare” në nënsektorin e “Korporatave të tjera financiare”.

Ndërsa për instrumentin “Depozita të papërfshira në paranë e gjerë” vërehet një rritje e lehtë e tij, për shkak të marrjes së informacionit të plotë për interesin

e përllogaritur për depozitat me afat mbi dy vjet (të cilat nuk janë pjesë e parasë së gjerë), informacion ky i papërfshirë në instrument, si dhe saktësimin e informacionit të depozitave mbi dy vjet për sektorin e korporatave të tjera financiare.

KLASIFIKIMI I KUNDËRPARTISË

Klasifikimi sipas sektorëve institucionalë konsiston në klasifikimin e instrumenteve financiare sipas sektorëve të ekonomisë, ku bën pjesë subjekti kundërparti. Sektorizimi i ekonomisë bëhet në përputhje me “Metodologjinë e Sistemit Evropian të Llogarive ESA 2010”, “Udhëzuesin e hartimit të statistikave monetare dhe financiare, FMN, 2008”, “Manualin e statistikave monetare dhe financiare, FMN, 2000”, dhe “Metodikën e statistikave monetare dhe Financiare, Banka e Shqipërisë, korrik 2003”.

Sipas këtyre dokumenteve metodologjike, përkufizimi i sektorëve kundërparti ka këtë kuptim:

1. Korporatat jofinanciare (S.11) përfshijnë njësi institucionale, të cilat janë subjekte juridike të pavarura dhe prodhues tregu, veprimtaria kryesore e të cilëve është prodhimi i mallrave dhe shërbimeve jofinanciare. Këto mund të jenë publike dhe private.
 - a. Korporatat jofinanciare private janë korporata jofinanciare rezidente, thuajse-korporata dhe institucione jo me qëllim fitimi, të cilat janë subjekte të pavarura ligjore dhe prodhues tregu, të cilët nuk kontrollohen nga qeveria dhe njësitë institucionale jorezidente.
 - b. Korporatat jofinanciare publike - janë korporata jofinanciare rezidente, thuajse-korporata dhe institucione jo me qëllim fitimi,

të angazhuara në prodhim tregu, që kontrollohen dhe financohen kryesisht nga qeveria. Kontrolli mund të ushtrohet nga zotërimi i më tepër se gjysmës së të drejtave votuese ose nëpërmjet ligjit, me dekrete ose me rregullore, të cilat vendosin politikën nëpërmjet të cilës qeveria mund të emërojë drejtuesit. Këtu përjashtohen institucionet jo me qëllim fitimi, të cilat nuk angazhohen në prodhim për tregun.

Praktikisht, në nënsektorin e korporatave jofinanciare klasifikohen të gjitha shoqëritë tregtare jofinanciare, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin nr. 9901 dt. 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Përjashtim bëjnë vetëm personat fizikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me nenin 1 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe që klasifikohen në sektorin "Individët" (Ekonomitë familjare).

2. Korporatat financiare (S.12) – përfshijnë bankën qendrore, korporatat e tjera depozituese, fondet e investimit, ndërmjetësit e tjerë financiarë përveç kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit, ndihmësit financiarë, kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit.
 - a. Banka qendrore (S.121) – ka si funksion kryesor të saj që të emetojë monedhën, të ruajë vlerën e brendshme dhe të jashtme të monedhës, si dhe të mbajë të gjitha ose një pjesë të rezervave ndërkombëtare të vendit.
 - b. Korporatat e tjera depozituese (S.122) – të cilat përfshijnë të gjitha korporatat financiare dhe thuajse – korporatat, të angazhuara kryesisht në ndërmjetësim financiar, kanë si veprimtari kryesore të pranojnë depozita, të japin kredi dhe të bëjnë investime në letra me vlerë. Në Shqipëri, ky nënsektor formohet nga bankat tregtare¹ dhe shoqëritë e kursim- kreditit².
 - c. Fondet e investimit (S.124), të cilat njihen edhe si fonde të përbashkëta ose institucione për investim kolektiv, përfshijnë të gjitha skemat e investimeve kolektive të angazhuara në ndërmjetësim financiar. Veprimtaria e tyre është të emetojnë aksione dhe kuota të fondeve të investimit, të cilat nuk janë zëvendësues të afërt të depozitave dhe të bëjnë investime në aktive financiare, afatshkurtra dhe afatgjata dhe në aktive jofinanciare (zakonisht në pasuri të patundshme). Në Shqipëri, këto institucione operojnë në përputhje me ligjin nr.10 198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".
 - d. Ndërmjetës të tjerë financiarë (S.125) – (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit vullnetar) dhe ndihmësit

¹ Të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë në bazë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

² Janë institucione jo me qëllim fitimi, të cilat organizohen si bashkime vullnetare të personave juridikë ose fizikë. Ato mbledhin fonde nga anëtarët e tyre dhe u japin kredi vetëm anëtarëve të tyre. Veprimtaria e tyre rregullohet nga ligji "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre" nr. 52/2016 dhe nga rregulloret e Bankës së Shqipërisë.

- financiarë (S.126) – përfshihen të gjitha institucionet e tjera, që kryejnë ndërmjetësim financiar apo lehtësojnë ndërmjetësimin financiar (përfshijtur shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit) të tilla si: institucionet e kreditit, institucionet që ofrojnë qiranë financiare (*leasing*), institucionet e financimit të transaksioneve tregtare, institucionet e mikrokredisë, faktoringut, të gjitha shërbimet e pagesave dhe transferimit të parave, Unionet e Shoqërive të Kursim - Kreditit, shoqëritë administruese të fondeve të investimit dhe të fondeve të pensionit vullnetar, zyrat e këmbimit valutor, etj.
- e. Shoqëritë e sigurimit (S.128) – ofrojnë shërbimet e sigurimit të jetës dhe jojetës për individë dhe shoqëri, si edhe risigurimin e shoqërive të tjera të sigurimit.
 - f. Fondet e pensionit (S.129) – përfshijnë të gjitha shoqëritë, të cilat janë të angazhuara kryesisht në ndërmjetësim financiar, si pasojë e grupimit të rreziqeve sociale dhe të nevojave të personave të siguruar. Këto janë fonde vullnetare, të cilat ashtu si skema e sigurimeve shoqërore, sigurojnë të ardhura pas daljes në pension dhe përfitime në raste paafësie dhe vdekjeje.
3. Qeveria e përgjithshme (S.13) përfshin tre nënsektorë të qeverisë: qeverinë qendrore, qeverinë lokale dhe Fondet e sigurimeve shoqërore.
- g. Qeveria qendrore - përfshin të gjitha departamentet administrative të shtetit dhe agjencitë qendrore, kompetencat e të cilave shtrihen mbi të gjithë territorin ekonomik të vendit. Të tilla janë: ministrinë dhe administrata publike qendrore, organizatat jo me qëllim fitimi, të kontrolluara nga qeveria.
 - h. Qeveria lokale – përfshin bashkitë dhe pushtetin lokal. Të përfshira në këtë nënsektor janë gjithashtu ato institucione jofitimprurëse, të cilat janë të kontrolluara nga pushteti vendor dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm brenda territorit ekonomik të qeverisë lokale.
 - i. Fondet e sigurimeve shoqërore – përfshijnë njësitë institucionale qendrore dhe lokale, veprimtaria kryesore e të cilave është të sigurojnë përfitime sociale. Në Shqipëri në këtë nënsektor klasifikohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.
4. Ekonomitë familjare (S.14) përbëhen nga individë dhe grupe individësh, të cilët janë kryesisht konsumatorë. Ata ndajnë të njëjtën banesë, mbledhin një pjesë ose të gjitha të ardhurat dhe konsumojnë kolektivisht mallrat dhe shërbimet.

Sektori i ekonomive familjare përfshin:

- (-) individë ose grupe anëtarësh funksioni kryesor i të cilëve është konsumi;
- (-) personat që jetojnë në mënyrë të përhershme në institucione, që kanë

pak ose aspak autonomi veprimi ose vendimi në çështjet ekonomike (p.sh.: anëtarët e sekteve fetare që jetojnë në manastire, personat e moshuar që jetojnë në mënyrë të përhershme në shtëpitë e të moshuarve (azile) etj).

- (-) individë ose grupe anëtarësh, funksioni kryesor i të cilëve është konsumi dhe që prodhojnë mallra dhe shërbime për përdorim final ekskluzivisht vetjak;
 - (-) pronësitë personale dhe bashkëpronësitë pa status juridik, (përveç atyre të cilat trajtohen si thuajse-korporata dhe që janë prodhues tregu). Të tillë do të konsiderohen personat fizikë, të cilët kryejnë veprimtari tregtare në përputhje me nenin 1, të ligjit nr. 9901 dt. 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
 - (-) institucionet jofitimprurëse që i shërbejnë ekonomive familjare, të cilat nuk kanë status të pavarur juridik.
5. Institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të individëve (S.15) përfshin institucionet jo me qëllim fitimi, të cilat janë njësi ligjore të pavarura, u shërbejnë ekonomive familjare dhe nuk prodhojnë për tregun. Institucione të tilla i sigurojnë ekonomive familjare mallra dhe shërbime falas ose me çmime që nuk janë ekonomikisht domethënëse. Llojet kryesore të institucioneve jo me qëllim fitimi në shërbim të ekonomive familjare janë:
- (-) sindikatat, shoqatat profesionale, shoqatat e konsumatorëve, partitë politike, kisha apo shoqëritë fetare (duke përfshirë edhe ato të financuara, por jo të kontrolluara nga qeveria) dhe klubet sociale, kulturore, sportive etj.; dhe
 - (-) organizatat bamirëse, mbështetëse dhe të ndihmës, të financuara nga transfertat vullnetare në parà (*cash*) ose në natyrë nga njësi të tjera institucionale.

Institucionet jo me qëllim fitimi, të cilat janë nën kontrollin e qeverisë klasifikohen në sektorin e qeverisë që i kontrollon ato.

PUBLIKIMI I TË DHËNAVE

Publikimi i të dhënave të korporatave depozituese, depozitave dhe huave do të jetë si në tabelën e mëposhtme:

Tabelat ekzistuese	Tabelat* e përmirësuara dhe të reja	Ndryshimet që sjellin Tabela me periodicitet mujor	Vendi i publikimit
Agregatët monetarë	Agregatët monetarë	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e përmirësimit të sektorizimit	Statistika/Seri kohore/ Mujore/Statistika monetare e financiare/ Agregatët monetarë
Bilanci Sektorial i Bankave Para Depozituese	Bilanci Sektorial i Bankave Para Depozituese	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e përmirësimit të sektorizimit dhe përfshirjes së interesit të përllogaritur për depozitat mbi 2 vjet, si dhe përfshirjes së depozitave mbi 2 vjet për korporatat e tjera financiare.	Statistika/Seri kohore/ Mujore/Statistika monetare e financiare/ Të dhëna të korporatave depozituese
Paraqitja e Bankave Para Depozituese	Paraqitja e Bankave Para Depozituese	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e përmirësimit të sektorizimit, përfshirjes së interesit të përllogaritur për depozitat mbi 2 vjet si dhe përfshirjes së depozitave mbi 2 vjet për korporatat e tjera financiare	Statistika/Seri kohore/ Mujore/Statistika monetare e financiare/ Të dhëna të korporatave depozituese
Bilanci sektorial i korporatave të tjera depozituese	Bilanci sektorial i korporatave të tjera depozituese	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e përmirësimit të sektorizimit, përfshirjes së interesit të përllogaritur për depozitat mbi 2 vjet, si dhe përfshirjes së depozitave mbi 2 vjet për korporatat e tjera financiare.	Statistika/Seri kohore/ Mujore/Statistika monetare e financiare/ Të dhëna të korporatave depozituese
Paraqitja e korporatave të tjera depozituese	Paraqitja e korporatave të tjera depozituese	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e përmirësimit të sektorizimit, përfshirjes së interesit të përllogaritur për depozitat mbi 2 vjet, si dhe përfshirjes së depozitave mbi 2 vjet për korporatat e tjera financiare.	Statistika/Seri kohore/ Mujore/Statistika monetare e financiare/ Të dhëna të korporatave depozituese
Paraqitja e Korporatave Depozituese	Paraqitja e Korporatave Depozituese	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e përmirësimit të sektorizimit, përfshirjes së interesit të përllogaritur për depozitat mbi 2 vjet, si dhe përfshirjes së depozitave mbi 2 vjet për korporatat e tjera financiare.	Statistika/Seri kohore/ Mujore/Statistika monetare e financiare/ Të dhëna të korporatave depozituese
Depozitat e përfshira në parane e gjerë	Depozitat e përfshira në parane e gjerë	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e përmirësimit të sektorizimit, përfshirjes së interesit të përllogaritur për depozitat mbi 2 vjet, si dhe përfshirjes së depozitave mbi 2 vjet për korporatat e tjera financiare.	Statistika/Seri kohore/ Mujore /Statistika monetare e financiare/Depozitat
Sasia e depozitave të reja mujore në euro për sistemin bankar	Sasia e depozitave të reja mujore të korporatave jofinanciare, individëve + institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas afatit në euro	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e përmirësimit të sektorizimit, përfshirjes së interesit të përllogaritur për depozitat mbi 2 vjet, si dhe përfshirjes së depozitave mbi 2 vjet për korporatat e tjera financiare.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore / Statistika monetare e financiare/Depozitat Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore / Statistika monetare e financiare/ Depozitat/Arkiva
Sasia e depozitave të reja mujore në lekë për sistemin bankar	Sasia e depozitave të reja mujore të korporatave jofinanciare, individëve + institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas afatit në lekë	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e përmirësimit të sektorizimit, përfshirjes së interesit të përllogaritur për depozitat mbi 2 vjet, si dhe përfshirjes së depozitave mbi 2 vjet për korporatat e tjera financiare.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore / Statistika monetare e financiare/Depozitat Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore / Statistika monetare e financiare/ Depozitat/Arkiva
Sasia e depozitave të reja mujore në USD për sistemin bankar	Sasia e depozitave të reja mujore të korporatave jofinanciare, individëve + institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas afatit në dollarë	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e përmirësimit të sektorizimit dhe dallimi i dy sektorëve (individë e biznese) sipas standardeve ndërkombëtare	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore / Statistika monetare e financiare/Depozitat Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore / Statistika monetare e financiare/ Depozitat/Arkiva

Depozitat me afat në lekë sipas subjektit dhe maturitetit	Depozitat në lekë sipas sektorit dhe maturitetit (gjendja në fund të periudhës)	Përmiësim i të dhënave si rrjedhojë e sektorizimit dhe përshatjes së instrumenteve sipas kërkesave të BQE.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore / Statistika monetare e financiare/Depozitat Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore / Statistika monetare e financiare/ Depozitat/ Arkiva
Depozitat me afat në euro sipas subjektit dhe maturitetit	Depozitat në euro sipas sektorit dhe maturitetit (gjendja në fund të periudhës)	Përmiësim i të dhënave si rrjedhojë e sektorizimit dhe përshatjes së instrumenteve sipas kërkesave të BQE.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore / Statistika monetare e financiare/Depozitat Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore / Statistika monetare e financiare/ Depozitat/ Arkiva
Depozitat me afat në dollarë sipas subjektit dhe maturitetit	Depozitat në dollarë sipas sektorit dhe maturitetit (gjendja në fund të periudhës)	Përmiësim i të dhënave si rrjedhojë e sektorizimit dhe përshatjes së instrumenteve sipas kërkesave të BQE.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore / Statistika monetare e financiare/Depozitat Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore / Statistika monetare e financiare/ Depozitat/ Arkiva
Kredia për ekonominë	Kredia për ekonominë	Përmiësim i të dhënave si rrjedhojë e sektorizimit.	Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredia
Sasia e huave të reja mujore në lekë për sistemin bankar	Sasia e huave të reja mujore të korporatave jofinanciare, individëve + institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas afatit në euro	Përmiësim i të dhënave si rrjedhojë e dallimit të dy sektorëve (individë e biznese) sipas standardeve ndërkombëtare.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredia Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredia/Arkiva
Sasia e huave të reja mujore në lekë për sistemin bankar	Sasia e huave të reja mujore të korporatave jofinanciare, individëve + institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas afatit në lekë	Përmiësim i të dhënave si rrjedhojë e dallimit të dy sektorëve (individë e biznese) sipas standardeve ndërkombëtare.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredia Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredia/Arkiva
Sasia e huave të reja mujore në dollarë për sistemin bankar	Sasia e huave të reja mujore të korporatave jofinanciare, individëve + institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas afatit në dollarë	Përmiësim i të dhënave si rrjedhojë e dallimit të dy sektorëve (individë e biznese) sipas standardeve ndërkombëtare.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredia Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredia/Arkiva
Kredia e re sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës (gjatë periudhës)	Huatë e reja sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës gjatë periudhës, flukset hyrëse të muajit.	Përmiësim i të dhënave si rrjedhojë e dallimit të dy sektorëve (individë e biznese) sipas standardeve ndërkombëtare.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredia Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredia/Arkiva
Kredia sipas aktivitetit ekonomik (gjendja në fund të periudhës)	Huatë e korporatave jofinanciare private sipas aktivitetit ekonomik (gjendja në fund të periudhës)	Përmiësim i të dhënave si rrjedhojë e sektorizimit dhe përditësimit me standardin NVE-R2.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredia Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredia/Arkiva
Kredia e re sipas aktivitetit ekonomik (gjatë periudhës)	Huatë e reja të korporatave jofinanciare private sipas aktivitetit ekonomik (flukset hyrëse të muajit)	Përmiësim i të dhënave si rrjedhojë e sektorizimit dhe përditësimit me standardin NVE-R2.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredia Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredia/Arkiva

Norma mesatare e depozitave mujore në euro për sistemin bankar	Norma mesatare mujore e depozitave të reja të korporatave jofinanciare, individëve + institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas afatit në euro	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e dallimit të dy sektorëve (individë e biznese) sipas standardeve ndërkombëtare.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit/Arkiva
Norma mesatare e depozitave mujore në lekë për sistemin bankar	Norma mesatare mujore e depozitave të reja të korporatave jofinanciare, individëve + institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas afatit në lekë	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e dallimit të dy sektorëve (individë e biznese) sipas standardeve ndërkombëtare.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit/Arkiva
Norma mesatare e depozitave mujore në dollarë për sistemin bankar	Norma mesatare mujore e depozitave të reja të korporatave jofinanciare, individëve + institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas afatit në dollarë	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e dallimit të dy sektorëve (individë e biznese) sipas standardeve ndërkombëtare.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit/Arkiva
Norma mesatare e huave mujore për sistemin bankar në euro	Norma mesatare mujore e huave të reja të korporatave jofinanciare, individëve + institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas afatit në euro	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e dallimit të dy sektorëve (individë e biznese) sipas standardeve ndërkombëtare.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit/Arkiva
Norma mesatare e huave mujore për sistemin bankar në lekë	Norma mesatare mujore e huave të reja të korporatave jo financiare, individëve + institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas afatit në lekë	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e dallimit të dy sektorëve (individë e biznese) sipas standardeve ndërkombëtare.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit/Arkiva
Norma mesatare e huave mujore për sistemin bankar në dollarë	Norma mesatare mujore e huave të reja të korporatave jo financiare, individëve + institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas afatit në dollarë	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e dallimit të dy sektorëve (individë e biznese) sipas standardeve ndërkombëtare.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit/Arkiva
Tabela të reja me periodicitet mujor			
Tabelë e re	Huatë sipas sektorit, monedhës dhe afatit (gjendja në fund të periudhës)*	Sektorizim më i mirë, saktësim i të dhënave dhe dallimi i dy sektorëve sipas standardeve ndërkombëtare.	Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Kredita
Tabelë e re	Depozitat në valutë sipas sektorit dhe maturitetit, (gjendja në fund të periudhës).	Tregues të rinj për të gjitha llojet e depozitave në monedhë të huaj sipas sektorëve.	Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/ Depozitat
Tabelë e re	Normat e interesit të huave të reja të korporatave jofinanciare sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	Dallimi i normave të interesit për të dy sektorët. Norma e interesit paraqitet sipas qëllimit të përdorimit, element i ri për këtë set të dhënash.	Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit
Tabelë e re	Normat e interesit të huave të reja të individëve + institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve, sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	Dallimi i normave të interesit për dy sektorët. Norma e interesit paraqitet sipas qëllimit të përdorimit, element i ri për këtë set të dhënash.	Statistika/Seri kohore/ Mujore/ Statistika monetare e financiare/Normat e interesit

Tabela me periodicitet tremujor			
Kredia sipas rrethit, subjektit dhe afatit (gjendja në fund të periudhës)	Degët - Huatë sipas rrethit, sektorit dhe afatit, gjendja në fund të periudhës.	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e sektorizimit dhe përfshirjes së instrumenteve sipas standardeve ndërkombëtare.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/Tremujore/ Statistika monetare e financiare/Kredia Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Muijore/ Statistika monetare e financiare/Kredia/Arkiva
Kredia për individët sipas rrethit dhe qëllimit (gjendja në fund të periudhës)	Degët - Huatë për individët sipas rrethit dhe qëllimit, gjendja në fund të periudhës.	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e sektorizimit.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/Tremujore/ Statistika monetare e financiare/Kredia Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Muijore/ Statistika monetare e financiare/Kredia/Arkiva
Kredia sipas rrethit dhe aktivitetit ekonomik (gjendja në fund të periudhës)	Degët - Huatë sipas rretheve dhe aktivitetit ekonomik, gjendja në fund të periudhës.	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e sektorizimit dhe përditësimit me standardin NVER2.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/Tremujore/ Statistika monetare e financiare/Kredia Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Muijore/ Statistika monetare e financiare/Kredia/Arkiva
Tabela e re	Degët - Huatë sipas monedhës dhe rrethit, gjendja në fund të periudhës.	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e sektorizimit	Statistika/Seri kohore/ Tremujore/Statistika monetare e financiare/ Kredia
Depozitat sipas rrethit	Degët - Depozitat sipas rrethit, gjendja në fund të periudhës.	Përmirësim i të dhënave si rrjedhojë e përmirësimit të sektorizimit dhe përfshirjes e interesit të përlogaritur për depozitat mbi 2 vjet.	Tabela e re: Statistika/Seri kohore/ Tremujore/ Statistika monetare e financiare/ Depozitat Tabela e vjetër: Statistika/Seri kohore/ Tremujore/ Statistika monetare e financiare/ Depozitat/Arkiva

* Për shkak të rumbullakimeve, në tabela mund të ekzistojë një mospërpulhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur në tabelë.

